

Bazuar në nenin 35 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me nenet 3, 27, 28, 30, 32, 34, 35, 41, 45, 46, 50 dhe 77 të Rregullores nr.2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësueseve të Sigurimit, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2015, miratoi:

RREGULLORE
MBI DEPOZITIMIN E ASETVE SI GARANCË, MJAFTUSHMËRISË SË
KAPITALIT, RAPORTIMIN FINANCIAR, MENAXHIMIN E RISKUT, INVESTIMEVE
DHE LIKUIDITETIN

PJESA I
PËRKUFIZIMET
Neni 1
Përkufizimet

Në këtë Rregullore, përveç nëse konteksti përcakton ndryshe:

Asetet e pranueshme nënkupton asetet totale të kalkuluara në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, minus “asetet e papranueshme”.

Dega është pjesë e siguresit të licencuar në juridiksionin e kompanisë amë dhe si e licencuar nga BQK-ja ushtron aktivitetin e sigurimeve në Kosovë.

Siguresit nënkupton kompanitë e sigurimeve jetë dhe jojetë, si dhe degët e jashtme të kompanive të sigurimeve jetë dhe jojetë, përveç kur është specifikuar ndryshe me dispozita të veçanta, me këtë Rregullore.

Kapitali themeltar nënkupton totalin e vlerës nominale të aksioneve të cilat lëshohen fillimisht nga kompania, ashtu siç ceket në dokumentet e themelimit. Kapitali themeltar mund të rritet duke lëshuar aksione të reja, atëherë kapitali themeltar do të jetë vlera totale e cila shfaqet kur shumëzohet vlera e një aksioni e cila gjendet në bursë (vlera nominale) me numrin total të aksioneve të mbajtura nga aksionarët e kompanisë. Kapitali themeltar po ashtu i referohet si kapital i aksionarëve.

Kapitali Variabil nënkupton shumën të cilën të gjithë siguresit e licencuar, në pajtim me nenin 3, duhet ta depozitojnë në një llogari të BQK-së, në një llogari të besuar në bankat komerciale të aprovuara nga BQK-ja, si dhe në forma të tjera të investimeve, të përcaktuara me këtë Rregullore.

Bord i drejtorëve nënkupton organin e nivelit më të lartë drejtues të korporatës, që emërohet me votën e barabartë të aksionarëve.

Drejtori nënkupton një person fizik i cili e ushtron autoritetin e një anëtarit të bordit të drejtorëve të një kompanie.

Llogaria e besuar nënkupton një llogari bankare e mbajtur në para të gatshme në emër të siguruesit, mjettet e të cilës nuk mund të lëvizin pa njoftimin paraprak të BQK-së.

Viti financiar nënkupton periudhën 12 mujore, e cila fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Për një kompani të sapo licencuar apo një ndërmjetësues të sapo licencuar viti financiar për të fillon nga data e licencimit të saj dhe përfundon më 31 dhjetor të atij viti kur kompania e ka marrë licencën. Pas kësaj viti financiar duhet të jetë nga 1 janari deri më 31 dhjetor të çdo viti.

Asetet e papranueshme nënkupton asetet e përfshira në raportin financiar të një siguruesi, të cilat përjashtohen me rastin e kalkulimit të margjinës minimale të solvencës.

Rasti i siguruar do të thotë një ngjarje, e cila kur shkaktohet, mund të shkaktojë dhënien e të drejtës për të marrë një kompensim sigurimi.

Tremujori nënkupton periudhën tremujore e cila përfundon më 31 mars, 30 qershor, 30 shtator dhe 31 dhjetor të çdo viti.

Tarifat nënkupton faktorët variabël të cilët kanë ndikim në kalkulimin e margjinës së solvencës, kapitalit variabël dhe mbajtjes së rrezikut. Tarifat do të rishikohen nga BQK-ja në baza vjetore dhe jo më larg se 15 gushti.

Mbajtja e rrezikut nënkupton shumën apo pjesën e shumës së siguruar nga një sigurues e cila nuk është e risiguruar.

Zyrtari i lartë nënkupton nivelin më të lartë të një zyrtari të një kompanie të sigurimit apo një ndërmjetësuesi të sigurimit.

Ekuiteti i aksionarëve nënkupton kapitalin themeltar të kompanisë plus profitet dhe rezervat, minus humbjet e mbajtura.

Margjina e Solvencës nënkupton margjinën minimale të solvencës, të kalkuluar si total i aseteve (pa asetet e papranueshme) minus detyrimet (duke e zbritur ekuitetin e aksionarëve), e cila duhet të jetë më e lartë se margjina minimale e solvencës.

Shuma e siguruar nënkupton shumën të cilën kompania e sigurimeve i premtonte t'i paguajë policëmbajtësit apo përfituesit pas ndodhjes së një rasti të siguruar.

Asetet totale nënkupton të gjitha asetet e vlerësuar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

IBNR (ang. incurred but not reported) nënkupton dëmet e ndodhura por ende të pa raportuara.

PJESA II
DEPOZITIMI I ASETEVE SI GARANCË
Neni 2
Kapitali Variabël

Të gjithë siguruesit jojetë duhet që si shtesë të depozitojnë një kapital variabël në një llogari të besueshme në banka komerciale të licencuar nga BQK-ja apo në forma të tjera të investimeve, siç është përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 3
Kalkulimi i Kapitalit variabël

1. Kapitali variabël është shuma e margjinës së riskut sigurues të një siguruesi jojetë, të kalkuluar në baza vjetore.
2. Nga një sigurues nuk kërkohet të depozitojë kapitalin variabël për një klasë sigurimi nëse nuk lëshon polica të reja për një periudhë 12 mujore. Kjo periudhë 12 mujore do të fillojë nga data kur siguruesi e ka ndalur lëshimin e sigurimit për një klasë të caktuar dhe kjo është vërtetuar nga BQK-ja.
3. Shuma e kapitalit variabël do të kalkulohet duke i përdorur tabelat në vijim, për të kalkuluar margjinën e riskut sigurues.

Tabela 1. Margjina e Riskut Sigurues

Risk Raporti - Kalkulimi i Kapitalit Variabël	Primet e Shkruara Bruto	Gjithsej Rezervat	Numri i Policave	Gjithsej Shuma e Siguruar	Gjithsej shuma e mbajtur e siguruar	Norma e Riskut Sigurues	Risku Sigurues i mbajtur
	a	b	c	d	e	f	= e * f
MTPL	- €	- €	0	- €	- €		- €
Sigurimet Kufitare	- €	- €	0	- €	- €	10.00%	- €
Kartoni Jeshil	- €	- €	0	- €	- €		- €
TPL+	- €	- €	0	- €	- €	10.00	- €
Kasko	- €	- €	0	- €	- €	1.00%	- €
Gjithsej Motoristikë	- €	- €	0	- €	- €	- €	- €
Sigurime nga Aksident dhe Shëndet	- €	- €	0	- €	- €	0.20%	- €
Sigurimet nga Marinë dhe Transport	- €	- €	0	- €	- €	0.35%	- €
Sigurime nga Aviacion	- €	- €	0	- €	- €	0.50%	- €
Sigurime nga zjarri dhe dëmtime tjera në pronë	- €	- €	0	- €	- €	0.03%	- €
Sigurimi i përgjegjësive	- €	- €	0	- €	- €	0.10%	- €
Sigurimi i Kredive dhe Garancioneve	- €	- €	0	- €	- €	0.30%	- €
Sigurimi për humbje financiare	- €	- €	0	- €	- €	0.30%	- €
Gjithsej Jomotoristikë	- €	- €	0	- €	- €		- €
Total Kapitali Variabël							- €

- a) Margjina e riskut sigurues për sigurimet kufitare, kalkulohet duke e shumëzuar kolonën “f” me kolonën “a”
 - b) Margjina e riskut sigurues për sigurimet TPL Plus, kalkulohet duke e shumëzuar kolonën “f” me kolonën “c”
 - c) Margjina e riskut sigurues për të gjitha sigurimet e tjera, kalkulohet duke e shumëzuar kolonën “e” me kolonën “f”.
 - d) Kalkulimi i riskut sigurues për produktin MTPL-së llogaritet sipas aneksit 1 në fund të kësaj Rregulloreje.
4. BQK-ja ka të drejtë që t’i rishikojë dhe ndërrojë koeficientet sipas nevojës.

Neni 4

Raportimi i Kapitalit variabël të kalkuluar në BQK

1. Kapitali variabël duhet të jetë shuma e kalkuluar në baza 12 mujore nga siguruesit dhe të raportohet në BQK në baza tremujore, duke i përdorur të dhënat nga tabela 1 për margjinën e riskut sigurues.
2. Për kalkulimin e kapitalit variabël do të përdoret njëra prej këtyre raporteve si në vijim të cilat japin shumën më të lartë për kapitalin variabël:
 - a) Kalkulimet nga raporti i fundit i audituar për vitin financiar.
 - b) Planin njëvjeçar të biznesit
 - c) Raportin e riskut sigurues
3. Siguruesit e licencuar, duhet t’i kenë finalizuar kalkulimet e tyre për vitin e ardhshëm financiar, për kapitalin variabël dhe t’i raportojnë në BQK në format të përcaktuar nga BQK-ja, jo më vonë se 30 nëntori i çdo viti.
4. Kalkulimi i kapitalit variabël bëhet në baza 12 mujore dhe raportohet në BQK në baza tremujore, 30 ditë pas përfundimit të tremujorit.
5. Në rast se gjatë aktivitetit sigurues, siguruesit dështojnë të mirëmbajnë nivelin minimal të kërkuar të kapitalit variabël, atëherë aksionarët janë të obliguar, që të shtojnë kapital shtesë në mënyrë që të mbulojnë mungesat e kapitalit variabël dhe të sjellin kompaninë në nivelin e kërkuar të kapitalit variabël, brenda afatit prej 30 ditësh.

Neni 5

Investimi i kapitalit variabël

1. Kapitali variabël i siguruesve, mund të investohet si në vijim:

- a) Depozita në bankat komerciale, të licencuara nga BQK-ja, jo më shumë se 30% të kapitalit variabël në një llogari të besuar në një bankë komerciale.
 - b) Letrat me vlerë të lëshuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, jo më shumë se 70% e kërkesave të kapitalit variabël dhe atë me afat maturimi deri në një vit.
2. Siguruesit jetë, mund të investojnë provizionet teknike-matematike ashtu siç është përcaktuar me Rregullin në fuqi për sigurimin e jetës.
 3. BQK-ja, sipas vlerësimit të saj, mund të kërkojë nga siguruesi në çdo kohë të ndërpresë investimin e bërë ose të kërkojë ndryshimin e kritereve të investimeve.

Neni 6

Të hyrat e interesit nga investimet

Të hyrat nga investimet, do të jenë në dispozicion për t'u përdorur nga siguruesit.

PJESA III

MJAFTUESHMERIA E KAPITALIT

Neni 7

Kapitali minimal themeltar dhe ekuiteti i aksionarëve

1. Të gjithë siguruesit si kusht për t'u licencuar duhet të depozitojnë dhe mirëmbajnë në çdo kohë 3 milionë euro si kapital themeltar.
2. Të gjithë siguruesit, do ta depozitojnë dhe mirëmbajnë 10% të kapitalit themeltar në BQK.
3. Pjesa tjetër e kapitalit themeltar të siguruesve, mund të investohet si në vijim:
 - a) Depozita në banka komerciale, të licencuara nga BQK-ja, jo më shumë se 20% të kapitalit themeltar në një llogari të besuar në një bankë komerciale.
 - b) Letra me vlerë të lëshuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me aprovimin paraprak të BQK-së.
4. BQK-ja, sipas vlerësimit të saj, mund të kërkojë nga siguruesi në çdo kohë të ndërpresë investimin e bërë ose të kërkojë ndryshimin e kritereve të investimeve.
5. Siguruesit janë të obliguar që gjatë gjithë aktivitetit sigures, të mirëmbajnë nivelin minimal të ekuitetit, jo më pak se shuma e kapitalit themeltar (min. 3 milionë euro)
6. Në rast se gjatë aktivitetit sigures, siguruesit dështojnë të mirëmbajnë nivelin e kërkuar minimal të ekuitetit, atëherë aksionarët e siguruesit janë të obliguar, që të shtojnë kapital shtesë në mënyrë

që të mbulojnë mungesat e kapitalit dhe të sjellin kompaninë në nivelin e kërkuar të ekuitetit, brenda 30 ditësh pas mungesës së konstatuar.

7. Mjetet për kapitalin themeltar të siguruesit dhe kapital shtesë nuk duhet të burojnë nga fondet e marra hua nga publiku, kredi bankare apo hua të tjera, që rrjedhin nga fondet, origjina e të cilave është e paligjshme dhe e panjohur.

Neni 8 **Margjina e solvencës**

Të gjithë siguruesit duhet të mirëmbajnë margjinën minimale të solvencës së kërkuar. Solvenca nënkupton totalin e asetëve (pa asetet e papranueshme) minus detyrimet (duke e zbritur ekuitetin), e cila duhet të jetë më e lartë se margjina minimale e solvencës së kërkuar.

Neni 9 **Margjina minimale e Solvencës së kërkuar**

Margjina minimale për siguruesit jojetë është 20% e shumës minimale të kapitalit themeltar.

Neni 10 **Asetet e papranueshme**

Asete te papranueshme janë me sa vijon:

- a) 100% e asetëve te paprekshme (duke përfshirë Goodwill-in),
- b) 100% e të gjithë debitorëve dhe të arkëtueshmeve të tjera, më te vjetra se 90 ditë,
- c) 25% e shpenzimeve të përvetësuar të shtyra, dhe
- d) 100% asetet e ngarkuara sipas nenit 11 të kësaj Rregulloreje.

Neni 11 **Ndalesat kundër asetëve të ngarkuara të miratuara**

Një aset është i papranueshëm kur ai është ngarkuar në favor të një personi tjetër, apo kur ai mbahet nga një person tjetër, përveç nëse personi në favor të të cilit është ngarkuar apo personi i cili e mban atë aset është BQK-ja. Asnjë sigurues nuk ka të drejtë që të përdorë si kolateral për marrje të çfarëdo lloj kredie, asetet që mbulojnë kapitalin variabil, provizionet teknike dhe matematike, apo kapitalin themeltar.

Neni 12 **Raportimi i Solvencës në BQK**

1. Margjina e solvencës duhet të kalkulohet në baza tremujore nga siguruesit dhe të raportohet në BQK.

2. Një sigurues i licencuar duhet ta finalizojë dhe ta raportojë në BQK kalkulimin e margjinës minimale të solvencës, në një format të caktuar nga BQK-ja, jo më larg se 30 ditë pas përfundimit të tremujorit.
3. Nëse margjina e solvencës është më e vogël se margjina minimale e solvencës, atëherë dallimi duhet të plotësohet, me kapital shtesë, jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të tremujorit. BQK-ja mund të rishikojë kalkulimin e shumës së kapitalit dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme.

Neni 13

Rregulli për vlerësimin e përgjithshëm

Asetet e pranueshme të siguruesit të licencuar do të vlerësohen dhe raportohen në bilancin e gjendjes në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, përveç nëse jepet sipas paragrafëve në vijim:

1. Letrat me vlerë do të vlerësohen sipas vlerës së tyre aktuale të tregut e që është çmimi i fundit i shitjes i kotuar në bursë apo në sistemin e tregtimit ku tregtohen.
2. Investimet në pronë do të regjistrohen sipas vlerës së tyre të tregut, pas zbritjeve të arsyeshme të shpenzimeve të shitjes. Vlerat e tregut do të përcaktohen nga një vlerësues i pavarur dhe i kualifikuar. Të gjitha pronat e paluajtshme, të mbajtura si investime duhet të vlerësohen së paku një herë në vit. Vlerësimet duhet të bëhen më shpesh kur kushtet e tregut tregojnë se vlerat bartëse të aseteve janë materialisht të ndryshme nga vlera e tregut.

Neni 14

Provizionet teknike

1. Provizionet teknike të një siguruesi si shtesë e detyrimeve të tij të përgjithshme duhet të vlerësohen nga Aktuari, në pajtim me atandardet aktuariale.
2. Provizionet teknike të siguruesit jojetë përbëhen nga rezervat për dëme dhe rezervat për primin e pafituar.

Rezervat për dëme përfshijnë:

- a) Dëmet e raportuara por të papaguara,
- b) Dëmet e ndodhura por ende të paraportuara (IBNR) duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Rezervat për prime përfshijnë:

- a) Rezervat për primet e pafituar
- b) Rezerva e riskut të paskaduar.

Neni 15
Detyrimi për të informuar BQK-në

Siguruesit e licencuar duhet që në çdo kohë kur të kuptojnë se nuk kanë mundësi të përballin kërkesën për margjinën minimale të solvencës ta njoftojnë BQK-në lidhur me situatën e tyre.

PJESA IV
KËRKESAT PËR RISIGURIM

Neni 16
Mbajtja e riskut për siguruesit e licencuar

Për të gjitha klasat e sigurimit, siguruesit e licencuar nuk do të ndërmarrin asnjë risk të vetëm i cili del nga një ngjarje e sigurueshme, i cili tejkalon 10% të kapitalit themeltar.

Neni 17
Dorëzimi i shumave të mbajtjes maksimale për rrezik në BQK

1. Shumat e mbajtjes duhet të kalkuloohen në baza tremujore nga siguruesit dhe të dorëzohet në BQK.
2. Siguruesit e licencuar duhet të dorëzojnë në BQK kalkulimin e finalizuar të shumave të mbajtjes duke u bazuar në planin e biznesit për vitin e ardhshëm kalendarik dhe ta dorëzojë në BQK, në formatin e caktuar nga BQK-ja, jo më vonë se 30 nëntor i çdo viti. Ky kalkulim duhet të dorëzohet në BQK duke u bazuar në shënimet aktuale brenda 30 ditëve pas përfundimit të tremujorit.

Neni 18
Blerja e risigurimit

1. Siguruesit e licencuar duhet të blejnë mbulesën e nevojshme risiguruese për dallimin në mes riskut të marrë në sigurim dhe nivelit maksimal të riskut të mbajtur. Mbulesa risiguruese duhet të jetë efektive, jo më vonë se 31 dhjetori, për vitin e ardhshëm kalendarik. Kjo mbulesë duhet të bazohet në planin e dorëzuar dhe të përtërirë gjatë vitit kalendarik, duke u bazuar në shënimet aktuale.
2. Nëse mbulesa risiguruese është më e vogël se mbulesa e kërkuar (siç kalkulohet nga dallimi në mes riskut të marrë në sigurim dhe nivelit maksimal të riskut të mbajtur) atëherë mbulesa shtesë duhet të blihet jo më vonë se 30 ditë pas identifikimit të mungesës.

Neni 19

Dorëzimi i programit të risigurimit në BQK

1. Programi i risigurimit është një listë e të gjitha kontratave të risigurimit të cilat specifikojnë termet e kontratës, emrin e risiguresit dhe pjesëmarrjen e tyre, të analizuar për çdo vit kalendarik.
2. Siguruesit e licencuar apo degët e siguruesve të jashtëm duhet të përgatitin programin e tyre risigures, duke u bazuar në planin e biznesit për vitin e ardhshëm kalendarik dhe ta dorëzojnë në BQK për aprovim, jo më vonë se 30 nëntori i çdo viti.

Neni 20

Kualiteti i risigurimit të blerë

1. Së paku njëherë në vit BQK-ja do të rishikojë programin e risigurimit dhe do të vlerësojë kualitetin e risigurimit të blerë duke u bazuar në rejtingun ndërkombëtar të risiguresve të publikuar nga Standard and Poor's apo ekuivalentë të saj.
2. BQK-ja nuk do të pranojë kontratat e risigurimit me kompanitë risigures me klasifikim afatshkurtër më të dobët se A-3 nga agjencionet e klasifikimit. Në rastet e kontratave risigures afatgjatë, klasifikimi afatgjatë duhet të jetë jo më i dobët se BBB+ nga nga agjencionet e klasifikimit.

PJESA V

INVESTIMET

Neni 21

Politikat e shkruara të investimeve

Siguruesit, duhet të kenë politikë të shkruar të investimeve, e cila në detale e përshkruan llojin e investimeve të cilat siguruesi do t'i bëjë. Politika e investimeve duhet të rishikohet në baza vjetore dhe duhet të aprovohet nga bordi i drejtorëve të kompanisë. Politika e investimeve të kompanisë do të jetë subjekt i ekzaminimit nga BQK-ja dhe duhet të jenë në harmoni me kornizën ligjore në fuqi.

Neni 22

Dorëzimi i raportit të investimeve në BQK

1. Raporti i investimeve duhet të jetë një listë e të gjitha investimeve, të përgatitur në baza tremujore dhe ta raportojnë në BQK jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të tremujorit.
2. BQK-ja mund të rishikojë raportin e investimeve dhe të ndërmarrë veprime të duhura sipas nevojës.

Neni 23
Komiteti i investimeve

1. Bordi i drejtorëve të një siguruesi duhet të themelojë komitetin e investimeve, i cili do t'i rekomandojë bordit drejtues për investimet e kompanisë.
2. Komiteti i investimeve do të përbehet nga minimum tre persona, nga të cilët shumica duhet të jenë rezident të Kosovës.
3. Kryesuesi i komitetit duhet të jetë anëtar i bordit drejtues.
4. Të gjithë anëtarët e komitetit të investimeve do të emërohen dhe shkarkohen sipas vendimit të bordit.

Neni 24
Detyrat e komitetit të investimeve

Komiteti i investimeve takohet së paku 4 herë në vit (çdo tre muaj) dhe duhet t'i raportojë bordit të drejtorëve për:

1. Sigurinë e investimeve si për nga kapitali ashtu edhe për nga të hyrat.
2. Likuiditetin e investimeve dhe koordinimin e aseteve në dispozicion për t'i përballuar obligimet të cilat mund të dalin.
3. Profitabilitetin e investimeve duke përfshirë një vlerësim nëse investimet janë mjaft profitabile për të mbuluar rritjen e detyrimeve të cilat dalin nga policat.
4. Devijimi nga politikat e përgjithshme të investimeve, udhëzimet, planet, objektivat apo strategjitë dhe ndikimin financiar të këtyre devijimeve.
5. Masat korrektuese të adoptuara për t'i kompensuar rezultatet e pafavorshme.
6. Ndryshimet apo përmirësimi i planit të investimeve, objektivave dhe strategjive, nëse paraqitet nevoja, si dhe ndikimi financiar i parashikuar i këtyre ndryshimeve apo përmirësimeve.
7. Rekomandimet për politikat e investimeve sipas nevojës.

PJESA VI
RAPORTIMI SHITESË FINANCIAR NGA ENTITETI SIGURUES,
DUKE PËRFSHIRË SHËNIMET E AUDITUARA

Neni 25
Auditimet vjetore

1. Çdo sigures apo ndërmjetësuesit e sigurimeve të cilët ushtrojnë aktivitet sigures në Kosovë duhet të dorëzojë raportin financiar vjetor, të audituar nga një kompani e pavarur audituese e licencuar nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF). Kompania e auditimit të jashtëm duhet të aprovet me shkrim nga BQK-ja për auditimin e jashtëm të pasqyrave financiare vjetore të kompanisë së sigurimeve.
2. Auditimi duhet të bëhet konform Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Auditimit si dhe rregullave të cilat mund t'i përcaktojë BQK-ja.
3. Kërkesa për aprovim të auditorit të jashtëm duhet të dërgohet në BQK deri më 30 qershor të vitit aktual për vitin e ardhshëm.

Neni 26
Standardet e Auditimit

Auditimi duhet të bëhet konform Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe rregullave të cilat mund t'i përshkruajë BQK-ja kohë pas kohe.

Neni 27
Koha e dorëzimit të raportit vjetor financiar

1. Siguresit dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve deri më datë 30 prill të çdo viti duhet të dorëzojnë në BQK, 3 kopje të raportit të audituar vjetor, si dhe letrën me komentet e menaxhmentit për vitin paraprak financiar.
2. Një kopje të raportit të audituar vjetor si dhe Letrën e Menaxhmentit duhet t'i dorëzojnë edhe në formë elektronike.
3. Të bashkëngjitur Raportit të auditorit të jashtëm, siguresi apo ndërmjetësuesi i sigurimeve duhet që deri më 30 prill të dorëzojë në BQK, margjinën minimale të solvencës së kalkuluar, nivelin e kapitalit – ekuitetit, kapitalin variabël, raportin e riskut, si dhe analizën dhe performancën e saj financiare, për vitin paraprak financiar në bazë të raportit të audituar.
4. Nëse auditori nuk bën verifikimin e raporteve financiare të siguresit, përfshirë raportin e riskut, metodologjinë e kalkulimit të riskut të përgjithshëm dhe riskut të mbajtur, kalkulimit të margjinës

minimale të solvencës dhe të kapitalit variabël, atëherë BQK-ja ka autoritetin të rritë minimumin e kërkesave për kapital variabël shtesë, për një sigurues të licencuar apo ndërmjetësues të sigurimeve.

Neni 28

Përgjegjësia mbi raportet e audituara financiare

1. Bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i një siguruesi të licencuar apo ndërmjetësuesi të sigurimeve janë përgjegjës për informimin financiar, të cilin e përmban një raport i audituar financiar i siguruesit të licencuar, dege të një siguruesi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve.
2. Një vendim i Kuvendit të Aksionarëve, i cili e aprovon një raport të audituar financiar, duhet të dorëzohet në BQK së bashku me raportin financiar vjetor të audituar.

Neni 29

Dorëzimi i planit të biznesit

Siguruesi i licencuar dhe dega e një siguruesi të jashtëm duhet të dorëzojë një plan biznesi në BQK çdo vit. Plani i biznesit për vitin e ardhshëm duhet të miratohet nga bordi i drejtorëve dhe zyrtarët e lartë të siguruesit dhe të dorëzohet në BQK deri më 30 nëntor të vitit aktual.

Neni 30

Përmbajtja e planit të biznesit

Plani i biznesit duhet të përfshijë:

1. Pasqyrën e të ardhurave, bilancin e gjendjes, raportin mbi rrjedhën e keshit, raportin e riskut dhe parashikimet për solvencën dhe kapitalin variabël për 12 muajt e ardhshëm, që përfundon më 31 dhjetor.
2. Informacion i detajuar, i cili e përkrah planin e biznesit për parashikimin e fitimit e bruto primeve, mesataren e primit, mesataren e shumës së siguruar dhe dëmeve të ndodhura, me një krahasim me shënimet aktuale për 12 muajt e fundit. Ky informacion duhet të prezantohet në analizën dhe performancën e raportit të riskut, në formatin të cilin e cakton BQK-ja.
3. Dorëzimi i riskut të planifikuar i shprehur në terme të secilës klasë së biznesit, numri i policave për t'u shitur dhe shumat totale të siguruara për 12 muajt e ardhshëm, me një krahasim të shënimeve aktuale për 12 muajt e fundit. Si shtesë, informacioni për margjinën e riskut të siguruar, duhet të merret për 12 muajt e ardhshëm. Ky informacion duhet t'i prezantohet në formatin e "Analizës dhe performancës së raportit të riskut"

4. Dorëzimi i “Mbajtjes së riskut të kalkuluar” dhe programit të risigurimeve, i cili e përkrah profilin e riskut të planifikuar për 12 muajt e ardhshëm.

Neni 31

Dorëzimi i shënimeve aktuale tre mujore, kundrejt planit të biznesit

1. Kompania e sigurimit duhet që në baza tremujore të dorëzojë në BQK, shënimet aktuale të krahasuara me shënimet e planit të biznesit dhe shënimet aktuale të periudhave paraprake në raport me pasqyrën e të ardhurave, bilancin e gjendjes, analizën dhe performancën e raportit të riskut, limiti i mbajtjes së riskut, pozita aktuale e solvencës dhe kolateralit, si dhe raportet ekzistuese të primeve dhe dëmeve të cilat përdoren.
2. Raporti tremujor duhet të përfshijë komentet për lëvizjet e rëndësishme nga plani i biznesit.
3. Raporti tremujor duhet të dërgohet në BQK brenda 30 ditëve pas përfundimit të tremujorit.
4. Raportet tremujore duhet të miratohen nga bordi i drejtorëve të kompanisë apo bordi i drejtorëve të kompanisë qendrore nëse entiteti është degë.

Neni 32

Raportet mujore të cilat duhet të dorëzohen në BQK

Çdo kompani e sigurimit duhet t’i dorëzojë raportet mujore në BQK, në kopje të shkruar apo elektronike brenda 15 ditëve kalendarike, duke filluar nga dita e fundit e muajit për të cilin është bërë raporti.

1. Raportin mujor të primit në pajtim me kërkesat e kësaj Rregulloreje.
2. Raportin mujor të dëmeve në pajtim me kërkesat e kësaj Rregulloreje.

Neni 33

Dorëzimi i raporteve mujore dhe tremujore materialisht jokorrekte apo mashtruese

Shënimet materialisht jokorrekte apo mashtruese të bëra me qëllim apo nga neglizhenca e një siguruesi të licencuar penalizohet si kundërvajtje dhe personave përgjegjës mund t’u ndalohet nga BQK-ja të jenë zyrtarë të lartë, shef i financave dhe anëtar të bordit të drejtorëve të një siguruesi të licencuar për një periudhë të përcaktuar nga BQK-ja.

Neni 34

Dorëzimi me vonesë i raporteve mujore, tremujore, vjetore dhe raporti i auditorit të jashtëm

Shqiptim i masës ndëshkuese në shumë prej 1,000 Euro për vonesë të dorëzimit të raporteve në BQK, sipas afatit të përcaktuar me ligj, si dhe nga 500 Euro për çdo ditë shtesë të kaluar nga data e përcaktuar për raportim.

PJESA VII
MASAT PREVENTIVE DHE KORREKTUESE

Neni 35

Masat preventive dhe korrektuese

1. Kur BQK-ja i ka imponuar limitet dhe/apo i ka vendosur kufizimet për aktivitetet e një siguruesi të licencuar, degë e një siguruesi të jashtëm apo ndërmjetësuesi të sigurimeve në pajtim me nenin 77 (d) të Rregullores nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit, BQK-ja mund që mes tjerash të imponojë limite tjera të mundshme dhe/apo kufizime:
 - a) Ta ndalojë një sigurues të licencuar, degë të një siguruesi të jashtëm apo ndërmjetësuesi të sigurimeve, të ushtrojë biznesin e sigurimeve për një klasë të caktuar biznesi.
 - b) T'i kërkojë një siguruesi të licencuar, dege të një siguruesi të jashtëm apo ndërmjetësuesi të sigurimeve, të marrë apo të përmbahet nga marrja e disa hapave apo të adoptojë një kurs të veçantë të veprimit apo të kufizojë fushën e biznesit të tij në një mënyrë të caktuar, apo
 - c) Të ndalojë një sigurues të licencuar, degë të një siguruesi të jashtëm apo ndërmjetësuesi të sigurimeve të hyjë në një transaksion të caktuar apo klasë të transaksioneve, apo hyrjes në to ndryshe nga rrethanat e specifikuara.

2. Kur një sigurues i licencuar, degë e një siguruesi të jashtëm apo një ndërmjetësues i sigurimeve është urdhëruar të ndërmarrë masa shtesë për t'i rezervuar asetet e saj, në pajtim me nenin 77(g) të Rregullores nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit, BQK-ja mes tjerash mund të urdhërojë edhe masa të tjera shtesë:
 - a) Të ndalojë siguruesin e licencuar, degën e një siguruesi të jashtëm apo ndërmjetësuesi të sigurimeve nga sistemimi apo largimi i një aseti i cili i takon atij gjatë një periudhe të specifikuar apo ta largojë një aset nga Kosova gjatë periudhës kur ai aset gjendet në Kosovë,
 - b) Të kërkojë nga një sigurues i licencuar, degë e një siguruesi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve, t'i mbajnë asetet në Kosovë të cilat kanë një vlerë të atillë për të cilën BQK-ja mendon se është e duhur për të siguruar se do të ketë mundësi t'i përballojë detyrimet e saj për biznesin e saj të licencuar,
 - c) Të ndalojë një sigurues të licencuar, degë të një siguruesi të jashtëm apo ndërmjetës të sigurimeve të ndërmarrë ndonjë obligim financiar në emër të ndonjë personi tjetër, dhe
 - d) Të ndalojë një sigurues të licencuar, degë të një siguruesi të jashtëm apo ndërmjetësi të sigurimeve të huazojë ndonjë shumë, për t'i paguar dividendët dhe apo për të shlyer ndonjë detyrim ndaj një personi lidhja e të cilit me siguruesin e licencuar, degën e një siguruesi të jashtëm apo ndërmjetësuesi të sigurimeve kërkohet të jetë e përshtatshme dhe e duhur sipas kësaj Rregulloreje.

3. Kur nga një sigurues i licencuar, degë a një siguruesi të jashtëm apo një ndërmjetës i sigurimeve është kërkuar të dorëzojë një plan rehabilitimi në pajtim me nenin 77 (i) të

Rregullores nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit, BQK-ja mund të përfshijë në këto kërkesa të planit për kompensim se siguruksi i licencuar, dega e një siguruksi të jashtëm apo një ndërmjetësues i sigurimeve të demonstrojnë se si do të mund t'i përballë solvencën minimale, kërkesat për kolateral dhe afatin për ndodhjen e kësaj rivendosje.

4. Kur BQK-ja emëron një këshilltar për një kompani të sigurimit, degë të një siguruksi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve, në pajtim me nenin 77 (j) të Rregullores nr. 2001/25, ky urdhër mund të sigurojë se:
 - a) Emërimi duhet të bëhet me shpenzime të kompanisë së sigurimit, degës së një siguruksi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve,
 - b) Këshilltari duhet të japë këshilla për udhëheqjen e drejtë të çështjeve të sigurimit dhe
 - c) Pastaj të raportojë në BQK, brenda tre muajve nga data kur ky person është emëruar apo në atë kohë kur BQK-ja e sheh të arsyeshme.

5. Kur BQK-ja kërkon nga firma e auditimit e një kompanie të sigurimit, degë të një siguruksi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve, që t'i raportojë drejtpërdrejt BQK-së, në pajtim me nenin 77 (k) të Rregullores nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit, BQK-ja mund të kërkojë që auditimi i çështjeve të një kompanie të sigurimit, degë të një siguruksi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve të:
 - a) Kryhet me shpenzime të kompanisë së sigurimeve, degës së një siguruksi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve,
 - b) Auditori të zgjidhet nga BQK-ja, dhe
 - c) Se auditori i kompanisë së sigurimeve, degës së një siguruksi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të jashtëm, të ndërrohet dhe një tjetër të emërohet sipas kërkesave të BQK-së.
 - d) Auditorit të mëparshëm i pamundësohet auditimi në institucionet financiare për së paku një vit.

6. Kur BQK-ja ka vendosur të marrë kontrollin mbi një kompani të sigurimit, degë të një siguruksi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve dhe asetet e saj në pajtim me nenin 77 (p) të rregullores nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit, BQK mund:
 - a) Të kërkojë nga siguruksi i licencuar, dega e një siguruksi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve, të transferojë kontrollin e aseteve të një klase të caktuar, te një person i miratuar nga BQK-ja,
 - b) Ta ndalojë siguruksin e licencuar, degën e një siguruksi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve, që ka të bëjë me të drejtat e palëve të treta, për të paguar apo transferuar ndonjë shumë te një person apo të krijojë ndonjë obligim për një gjë të tillë.

7. Masat preventive dhe korrektive të dhëna nga BQK-ja, sipas këtij neni, do të jenë për një periudhë të tillë, për të cilën BQK-ja e konsideron të nevojshme dhe mund të zgjatet sipas nevojës.

Neni 37

Administrimi i përkohshëm

1. Kur BQK-ja ta ketë emëruar një administrator të përkohshëm, në vend të menaxhmentit aktual të kompanisë së sigurimeve, degës së sigurveit të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve në pajtim me nenin 77 (n) të Rregullores nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit, mund të kërkojë siç vijon:
 - a) Shpenzimet e administrimit të paguhen nga sigurvei i licencuar, dega e një sigurvei të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve,
 - b) Administratori i përkohshëm duhet të jetë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të BQK-së dhe me kufizime të nevojshme, ta ketë fuqinë e njëjtë sikur të bordit të drejtorëve.
2. Administratori i përkohshëm do ta marrë kontrollin dhe menaxhimin e sigurveit të licencuar, degës së një sigurvei të jashtëm apo ndërmjetësuesi të sigurimeve që nga data e emërimit të tij si administrator.
3. Administratori i përkohshëm mund të kërkojë një person, i cili më parë e ka pasur një pozitë si anëtar i bordit apo drejtor i sigurveit të licencuar, degës së një sigurvei të jashtëm apo ndërmjetësuesi të sigurimeve, që t'i ofrojë informata apo dokumente të caktuara lidhur me biznesin e sigurveit të licencuar, degës së sigurveit të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve.
4. BQK-ja mund ta shkarkojë në çdo kohë administratorin e përkohshëm nga pozita e tij.

Neni 38

Detyrat e administratorit të përkohshëm

1. Administratori i përkohshëm është subjekt i kontrollit të BQK-së dhe duhet t'i ndjekë udhëzimet e dhëna nga BQK-ja.
2. Administratori i përkohshëm duhet që sa më shpejt që është e mundur pas fillimit të menaxhimit të një sigurvei të licencuar, degë të një sigurvei të jashtëm apo ndërmjetësuesi të licencuar, apo një pjese të biznesit të një sigurvei të licencuar, degë të një sigurvei të jashtëm apo ndërmjetësuesi të sigurimeve, të dorëzojë në BQK një raport me veprimet dhe rekomandimet të cilat sipas mendimit të tij janë të nevojshme dhe po ashtu t'i japë edhe arsyet e rekomandimeve të tilla.
3. Administratori i përkohshëm mund të rekomandojë transferimin e biznesit apo një pjese të biznesit të një sigurvei të licencuar, degë të një sigurvei të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të

sigurimeve, te një sigurues tjetër i licencuar, degë e një siguruesi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve vazhdimësinë e biznesit për një periudhë të administrimit dhe likuidimit të siguruesit të licencuar, degës së siguruesit të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve apo ndonjë masë tjetër veprimi, për të cilën ai e konsideron të arsyeshme apo të nevojshme. Administratori i përkohshëm mund të rekomandojë veprime të ndryshme për pjesë të ndryshme të një siguruesi të licencuar, dege të një siguruesi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve.

4. Raporti i përgatitur nga administratori i përkohshëm duhet të jetë në dispozicion për inspektim nga publiku, në atë vend të cilin e cakton BQK-ja.
5. Nëse BQK-ja e urdhëron transferimin e biznesit apo një pjese të biznesit të një siguruesi të licencuar, dege të një siguruesi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve, te një sigurues tjetër i licencuar, dege të një siguruesi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve, administratori duhet të përgatitë një plan për një transfer të tillë.
6. Administratori i përkohshëm duhet t'i paguajë kompensimet për dëmet apo humbjet e pësuar nga siguruesi i licencuar, dega e një siguruesi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve, apo ndonjë pale të tretë, nëse dëmi apo humbja është shkaktuar nga mashtrimet, neglizhenca apo mosgatishmëria për t'i aplikuar dispozitat e ligjit nga ana e administratorit të përkohshëm.
7. Kontrolli dhe menaxhmenti i një siguruesi të licencuar, dege të një siguruesi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve, mund të ndërpritet nga administratori i përkohshëm, nëse BQK-ja vendos se kontrolli dhe menaxhmenti i një siguruesi të licencuar, dege të një siguruesi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve, nuk është më tutje i nevojshëm.
8. BQK-ja më tutje mund t'i rregullojë të drejtat dhe obligimet e një administratori të përkohshëm, me rregullore, duke përfshirë shlyerjen obligimeve të një siguruesi të licencuar, dege të një siguruesi të jashtëm apo ndërmjetësuesi të sigurimeve.

Neni 39

Suspendimi i licencës

1. Kur BQK-ja e suspendon licencën e një siguruesi të licencuar, dege të një siguruesi të jashtëm apo ndërmjetësuesi të sigurimeve, në pajtim me nenin 77 (q) të Rregullores nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit, kushtet mund t'i bashkëngjiten suspendimit me sa vijon:
 - a) Ndalimin e zhvillimit të ndonjë biznesi nga siguruesi, dega e një siguruesi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve edhe atë nga data efektive e suspendimit, dhe
 - b) Masa të tilla BQK-ja mund t'i ndërmarrë si nevojë për mbrojtjen e interesit të kreditorëve dhe klientëve të siguruesit, degës së një siguruesi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve.

2. Nëse licenca është suspenduar dhe termet janë dhënë, këto terme duhet të përmbushen nga siguruesi, dega e një siguruesi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve në mënyrë që suspendimi të tërhiqet.

Neni 40

Inicimi i administrimit ligjor

Pas revokimit të licencës, BQK-ja duhet menjëherë të emërojë një administrator ligjor, për të marrë në kontroll, siguruesin, degën e një siguruesi të jashtëm apo një ndërmjetësuesi të sigurimeve. Një veprim i tillë do të njihet si administrim ligjor dhe duhet të drejtohet në pajtim me kapitullin X mbi administrimin ligjor, të Rregullores nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit.

Neni 41

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja mbi Depozitimin e aseteve si garancë, Mjaftueshmerisë së kapitalit, Raportimin financiar, Menaxhimin e riskut, Investimeve dhe Likuiditetin e datës 29 dhjetor 2011, Udhëzimi Administrativ nr. 01/2009 mbi Investimin e Fondit Garantues të Kompanive për Sigurimin e Jetës, si dhe çdo akt apo dispozitë tjetër juridike që bie në kundërshtim me këtë Rregullore.

Neni 42

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 15 maj 2015.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Bedri Peci

Aneksi 1

	Grup Tarifat		Numri i Policave	Kapitali Variabël
	Nga - Deri	Risku i Siguruar		
1. Automjete për pasagjer (cm3)	0 - 750	33		
	750 - 900	40		
	901 - 1100	50		
	1101 - 1300	55		
	1301 - 1500	60		
	1501 - 1700	70		
	1701 - 1950	85		
	1951 - 2250	105		
	2251 - 2700	120		
	Më shumë se 2701	140		
	2. Kamion (t)	0 - 0,5	100	
0,5 - 1		110		
1 - 2		135		
2 - 3		165		
3 - 5		200		
5 - 7		235		
7 - 10		295		
10 - 15		400		
Më shumë se 15		495		
3. Autobus	Primi Bazë	250		
		325		

	Grup Tarifat		Numri i Policave	Kapitali Variabël
	Nga - Deri	Risku i Siguruar		
Grupi Tarifor 3. Autobus NdërUrban	< 55 Ulëse	310		
	> 55 Ulëse	490		
4. Traktor (Kw)	Deri në 18	10		
	18 - 25	20		
	25 - 33	20		
	33 - 44	25		
	44 - 73	30		
	73 - 110	40		
	110 - 147	55		
	Më shumë se 147	65		
5. Motocikleta (cm3)	0 - 50	15		
	50 - 100	25		
	100 - 175	30		
	175 - 250	45		
	250 - 500	65		
	Më shumë se 500	85		
6. Rimorkiot (t)	0 - 1	15		
	1 - 3	20		
	3 - 5	25		
	5 - 10	35		
	10 - 15	55		
	Më shumë se 15	65		